



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 4406 Prot.

Tiranë, më 17. 12. 2019

Lënda: Kërkesë për ndryshim të rendit të ditës të seancës plenare të datës 18.12.2019

Drejtuar: Kryetarit të Kuvendit
z. Gramoz RUÇI

K Ë T U

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 31, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, kërkojmë që në rendin e ditës të seancës plenare të datës 18.12.2019 të futen për shqyrtim dhe miratim dy aktet normative, respektivisht:

- Akt normativ "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore";
- Akt normativ "Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019"

Këto akte normative janë futur automatikisht në Programin e Punimeve të Kuvendit dhe komisioni Për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës i ka përfunduar procedurat e shqyrtimit si dhe ka përgatitur raportet përkatëse për t'i kaluar në seancë plenare.

Duke vlerësuar rëndësinë e këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, shpallur nga Këshilli i Ministrave për tërmetin e 26 nëntorit 2019, propozojmë futjen në rendin e ditës së seancës plenare për shqyrtim e miratim.

Gjithashtu, propozojmë që në këtë rend dite të futet për votim, si çështje e mbartur nga seanca e fundit plenare e sesionit të kaluar korrik 2019, projektvendimi për plotësimin e vakancës me një anëtar të Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me dy kandidaturat e propozuara dhe mbështetura nga dy grupe prej 28 deputetësh.

Duke Ju falënderuar për vëmendjen,

**Kryetari i Grupit Parlamentar
të Partisë Socialiste**

Taulant BALLA